

## **DOKUMENTET QË DUHEN PËR TË MARRË SHTETËSINË SHQIPTARE**

1. Kërkesë drejtuar Presidentit të Republikës me arsyet e aplikimit, adresën, numër të mundshëm telefoni, e firmosur.
2. Çertifikatë e lindjes origjinale, e përkthyer, noteruar dhe legalizuar në ambasadën tonë në shtetin e banimit.
3. Dokument rezidence në Shqipëri (vetëm Leje Qëndrimi, e lëshuar nga Ministria e Rendit Publik sipas rasteve të parashikuar në ligj, për 5 vjet, 3 vjet ose 1 vit).
4. Akti i pronësisë së banesës në Shqipëri, ose kontrata e qirasë.
5. Kontratë pune për të punësuarit, vërtetim nga zyra e tatimeve për të vetëpunësuarit apo investitorët, ose vërtetim pensioni.
6. Dokument për të ardhurat.
7. Dëshmi penaliteti nga Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë, si dhe në shtetin nga vjen.
8. Marrëveshje para noterit e të dy prindërve për dhënien e shtetësisë së fëmijëve të mitur.

**VO** 1- Nëse personi është azilant politik duhet të paraqesë dokument origjinal për këtë.

- 2- Nëse personi pretendon të ketë aktivitet të veçantë në shërbim të shtetit shqiptar, një institucion qendror shqiptar, si Akademia e Shkencave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Kulturës, etj, paraqet një raport vlerësues në formë propozimi pranë Presidentit të Republikës, të shoqëruar me çertifikatën e personit, dëshmitë e penalitetit në të dy shtetet dhe kërkesën e tij, drejtuar Presidentit të Republikës
- 3- Të gjithë fëmijët mbi 14 vjeç të aplikojnë më vete. Për aplikantët deri në 18 vjeç praktikës duhet t'i bashkëlidhet dhe një deklaratë noteriale e të dy prindërve ,ku të shprehet pëlqimi i tyre për fitimin e shtetësisë shqiptare.
- 4- Dokumentet duhet të jenë lëshuar jo më parë se dy muajt e fundit nga dita e pranimit të tyre.